VENDIM
Nr. 25, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ANIO OIL & GAS" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR PËR NJË AFAT 5-VJEÇAR

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", neni 14, pika 1, germa "ç", si dhe neni 4, pika 1, germa "ç"; neni 8, neni 9 pika 1, germa "a", "b", "c", "d", "e"; pika 2, germa "e" dhe nenin 10 pika 1 dhe pika 11 të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror," miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2. 2011; Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Anio Oil & Gas" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për Licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Anio Oil & Gas" sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të kësaj shoqërie, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE:

- Dokumentacioni i përgjithshëm;

Nenin 9, pika 1 , germa ("a", "b", "c") (Formati i aplikimit plotësuar në mënyre korrekte) dhe neni 9, pika 1, germa ("d/i", "d/ii") (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor) është plotësuar në mënyre korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale;

Neni 9, pika 1, germa "e/V" (Pagesës së aplikimit në ERE), neni 9, pika 1, germa "e/VI" (Plan biznesi), neni 9, pika 1, germa "e/ i" (Sigurimet shoqërore dhe tatim taksat), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Anio Oil & Gas" sh.a. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti